



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. i org. Org. Jedinica Org. Unit	DL
Nr. i Faqeve Pr. Stranica No. Pages	-02-
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	7363-2/24
Data: Datum: Date	21.11.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Për:	Gazmend Muhaxheri, Kryetar i Komunës së Pejës Rexhep Kurtbogaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Pejës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Afrim Murati, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. WL- 175/24 Datë: 11.11.2024
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Shendrita Latifi - zyrtare ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisës së vendimit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 62/2024 për shpalljen e interesit publik për ngastrën kadastrale P - 71611077-00203-3 ZK. Ramun për krijimin e hapësirave për varreza në fshatin Ramun, miratuar nga Kuvendi Komunal i Pejës, datë 29.10.2024

I nderuar kryetar Muhaxheri,
I nderuar kryesues Kurtbogaj

Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 08.11.2024 ka pranuar nga MAPL Vendimin Nr. 62/2024 për shpalljen e interesit publik për ngastrën kadastrale P - 71611077-00203-3 ZK. Ramun për krijimin e hapësirave për varreza në fshatin Ramun, miratuar nga Kuvendi Komunal i Pejës, datë 29.10.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin

dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave konstaton se:

Pronat e shpallur me interes publik sipas Vendimit 62/2024, të miratuar nga Kuvendi Komunal i Pejës është pronë private andaj në bazë të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, Komuna ka të drejtë të bëjë shpronësimin e pronave private brenda territorit të saj për realizimin e projekteve të planifikuara sipas dokumenteve përkatëse, pra komuna është vet Organ Shpronësues.

Në rastin konkret procedura e shpronësimit duhet të kryhet vetëm nga Kryetari i Komunës dhe MMPHI nuk ka asnjë obligim në këtë procedurë dhe nuk duhet të përmendet në asnjë pikë të vendimit dhe në asnjë Vendim. Megjithatë, procedura e shpronësimit të bëhet duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 2 ndërsa nxjerrja e Vendimeve të bëhet në bazë të nenit 8, 10 dhe 11 të ligjit të përmendur më lartë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës mbetet në dispozicion të Komunës së Pejës dhe MAPL-së për çdo sqarim të mëtejshëm në lidhje me këtë vendim.

